# DËSHMI ARKIVI

**A-476078**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Vodhën 6 makina në Kavajë, Durrës dhe Tiranë, në pranga 2 autorët! Morën edhe lekët e një karburanti - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/vodhen-6-makina-ne-kavaje-durres-dhe-tirane-ne-pranga-2-autoret-moren-edhe-leket-e-nje-karburanti/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 11:30:17 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 11:22:20 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `dd24c1be63cba275082f8e474c8e8937e6d2e67ec0e9e636870c25e1e4f46819` |
| TEKSTI | `151b1ed02f83eb91abbc4c72310eb08b01276ffd0f3ca3a345133ec8f2dbe54d` |
| PAMJA | `91c1e47ed3012a2e1461c9b640596a57ab2011707841fe12b8a8133283a19acb` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `43153748edbdc52f2d71cc8c707236f953ff698d40e86a04fd7e06929adc9b9c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `37c1183d944b9abe724532469e5e873d69da6740426bb5bc7e8618c3c9fa36bf` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/43153748edbdc52f2d71cc8c707236f953ff698d40e86a04fd7e06929adc9b9c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET | VENDI

# Vodhën 6 makina në Kavajë, Durrës dhe Tiranë, në pranga 2 autorët! Morën edhe lekët e një karburanti

28 Shtator 2026 | 13:22

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Dy persona janë vënë në pranga gjatë mbrëmjes së djeshme nga Policia e Kavajës, pasi dyshohet se janë autorët e 6 rasteve të vjedhjes së makinave. Sipas raportimit të policisë, këta persona kanë vjedhur 1 makinë në Kavajë, 3 në Durrës dhe 2 në Tiranë.

Gjithashtu, sipas njoftimit bëhet e ditur se në pranga kanë rënë L. R., 37 vjeç, dhe A. H., 32 vjeç, persona të cilët dyshohet gjatë vjedhje së automjetit në Kavajë janë larguar, pasi janë ndihmuar nga shtetasit L. D. dhe B. S., të cilët janë arrestuar pasi kanë kundërshtuar me dhunë punonjësit e Policisë.

Përveç rasteve të vjedhjes së makinave, shtetasi A. H. ka marrë gjithashtu me dhunë xhiron ditore në një pikë karburanti në Bulqizë.

**Njoftimi i plotë i policisë:**

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Kavajë, si rezultat i hetimeve të kryera për zbardhjen e vjedhjeve, identifikimin dhe kapjen e autorëve, organizuan dhe finalizuan në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Durrës, operacionin e koduar “Cooperation”.

Në kuadër të këtij operacioni u arrestuan shtetasit L. R., 37 vjeç dhe A. H., 32 vjeç, të dy banues në Tiranë. Këta shtetas ishin shpallur në kërkim pasi më datë 24.09.2026, kanë vjedhur një automjet në Kavajë dhe më pas janë larguar, pasi janë ndihmuar nga shtetasit L. D. dhe B. S. (të arrestuar), të cilët kanë kundërshtuar me dhunë punonjësit e Policisë.

Gjatë operacionit të koduar “Cooperation”, shërbimet e Policisë kanë lokalizuar automjetin me të cilin qarkullonin këta shtetas dhe i kanë bërë shenjë për ndalim, por ata nuk janë bindur dhe kanë kundërshtuar veprimet e punonjësve të Policisë.

Nga verifikimet rezultoi se automjeti me targa të huaja me të cilin qarkullonin këta shtetas ishte i vjedhur.

Nga hetimet dyshohet se këta shtetas, gjatë muajit shtator, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë vjedhur 3 automjete, në Durrës, ndërsa në Tiranë kanë vjedhur 2 automjete, në njërin rast duke kanosur me thikë, pronarin e automjetit.

Gjithashtu, dyshohet se më datë 17.09.2026, shtetasi A. H. ka vjedhur me dhunë një shumë parash (xhiron ditore), në një pikë karburanti, në Bulqizë.

LAJMI I FUNDIT

13:10 Kuvendi i Kosovës miraton deklaratën për ish-krerët e UÇK-së: Kundërshtojmë vendimin e padrejtë

13:03 Kombëtarja mbyll përgatitjet në “Shtëpinë e Futbollit” për ndeshjen ndaj San Marinos

13:00 SpaceX do të dërgojë raketën Starship në orbitën e Tokës, për herë të parë pas tre vitesh testimesh

12:54 Nvidia lançon një platformë sigurie për agjentët e inteligjencës artificiale, ja si funksionon

12:41 Zbardhen diskutimet në Këshillin e Sigurisë për çështjen Hyseni, Presidenca jep detajet! I pranishëm dhe Kreu i SPAK

12:39 Po transportonte 16 emigrantë të paligjshëm drejt Malit të Zi, arrestohet 39-vjeçari në Shkodër

TESTIM

Vijojnë hetimet për zbardhjen e vjedhjeve të tjera që mund të kenë kryer këta shtetas.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme.

**Shiko në:**

## LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI

### Po transportonte 16 emigrantë të paligjshëm drejt Malit të Zi, arrestohet 39-vjeçari në Shkodër

Një 39-vjeçar është arrestuar këtë të hënë, pasi u kap në flagrancë duke ndihmuar 19 emigrantë të paligjshëm të kalonin ilegalisht kufirin drejt Malit të...

12:39 | 28/09/2026

AKTUALITET | VENDI

### Protestë në Maliq, banorët: Po na marrin ujin për fshatin tjetër

Banorët e fshatit Burimas, në Maliq, kanë dalë sërish në protestë këtë të hënë, duke u përplasur me policinë dhe përfaqësuesit e ujësjellësit, duke refuzuar...

11:47 | 28/09/2026

AKTUALITET | VENDI

### Vrasja e Egli Progës, të akuzuarit kërkojnë gjykim të shkurtuar! Shtyhet për në tetor seanca

Seanca e radhës e gjykimit paraprak për vrasjen e Egli Progës ka zgjatur më shumë se dy orë, ndërsa të akuzuarit kanë kërkuar që çështja...

11:46 | 28/09/2026




Copyright © Euronews 2026


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.